



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.399/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković -Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE N.N.SH “Emsa”- Suharekë, kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i kiosqeve ne sheshin “Adem Jashari”, me numër të prokurimit: 644-20-771-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Vushtrri, me datën 27.07.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit OE N.N.SH “Emsa”- Suharekë kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i kiosqeve ne sheshin “Adem Jashari”, me numër të prokurimit: 644-20-771-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Vushtrri.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndertimi i kiosqeve ne sheshin “Adem Jashari”, me numër të prokurimit: 644-20-771-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Vushtrri, dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik OE N.N.SH “Emsa”- Suharekë aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues N.N.SH "Emsa"- Suharekë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 22.06.2020, me nr. 399/20, kundër njoftimit për dhënien e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ndertimi i kiosqeve ne sheshin "Adem Jashari", me numër të prokurimit: 644-20-771-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Vushtrri, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,59 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.06.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe atë teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues dhe ai teknik i prokurimit në raportin e dt: 01.07.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqarojnë si në vijim:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues - Komuna e Vushtrri, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është pune, me vlerë të mesme. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës. Kundër të njëjtit propozim parashtuesi i ankesës në afatin e paraparë me LPP, ka paraqitur kërkesë për ri shqyrtim pranë AK, me pretendimet e njëjta si në OSHP. AK/ Komuna Vushtrri përmes vendimit të datës.10.06.2020, ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar, me arsyetimin kryesor se OE i propozuar për dhënie i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Përgjigje në pretendimet ankimore (neni 113):

- Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se parashtuesi i ankesës përmes deklaratës potencon se operatorët ekonomik të kualifikuar si të përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët nuk kanë prezantuar dëshmi, përkatësisht projekte të njëjta, sipas kërkesës së AK-së.
- Autoriteti Kontraktues / Komuna Vushtrri, përmes kërkesës së dosjes së tenderit, ka kërkuar projekte për punë apo furnizime të **ngjashme**, pa e përcaktuar vlerën e projekteve dhe minimumi një projekt të

realizuar në tri vitet e fundit (shih kërkesën 9.1&9.2, pozicioni 1 i FDT-së)

Operatori ekonomik i propozuar për dhënie të kontratës OE “Mazreku & AAB Construction”, së bashku me ofertë ka prezantuar listën e projekteve të realizuara, së bashku me dëshmitë dokumentare siç janë referencat apo pranimit teknik i punëve, pra i njëjti e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktues.

Po ashtu edhe operatori ekonomik tjetër, OE “Kopshti” shpk, së bashku me ofertë ka prezantuar listën e projekteve të realizuara, si dhe dëshmitë tjera, kopjet e referencave apo pranimeve teknike, ku vërtetohet që i njëjti ka realizuar projekte të ngjashme. Si provë këtij raporti do i bashkëngjisim listat e projekteve të prezantuara në oferta.

Përfundimisht, sqarojmë se AK, ka kërkuar projekte të ngjashme (jo të njëjta siç potencohet në ankesë), prandaj pretendimet ankimore i kualifikojmë si të pa bazuara.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, rrjedhimisht ti lejohet AK-së, të procedoj tutje me aktivitet të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues, me datën 01.07.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datën 01.07.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 27.07.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues N.N.SH “Emsa”- Suharekë se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë “Mazreku & Aab Construction” nuk e plotëson kërkesën lidhur me kontratat dhe referencat sepse në ofertën e tij ka ofruar/dorëzuar vetëm dy kontrata, ku njëra sipas titullit është rrethojë metalike e që nuk ka të bëjë fare me kërkesën e dosjes së tenderit dhe kontrata tjetër është sipas natyrës së kërkesës së dosjes së tenderit por nuk e ka përfunduar dhe nuk ka referencë dhe as pranim teknik, kontratë e cila është nënshkruar me 22.01.2020. Më tej, OE ankues shton se anëtar i konsorciumit AAB Construction në

listën e kontratave ka paraqitur 25 kontrata nga të cilat asnjëra nuk ka të bëjë me kërkesën e dosjes së tenderit për faktin se të gjitha janë renovim, mirëmbajtje shtrim trotuari. Paneli Shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me kërkesën për kontrata të ngjashme, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar për shkak se duhet që AK të vërtetoj pretendimin e OE ankues lidhur me kontratën për rrethoja metalike dhe të vërtetoj nëse OE i rekomanduar ka dorëzuar referencën për kontratën tjetër. Gjithashtu, AK të vërtetoj nëse edhe kontratat e anëtarit të konsorciumit “AAB Construction” nuk janë të natyrës së ngjashme.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.N.SH “Emsa”- Suharekë se OE “Kopshti” nuk i ka kontratat dhe referencat sipas kërkesës së dosjes së tenderit, ku në listën e kontratave i ka dorëzuar gjashtë kontrata, ku asnjëra nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit sepse AK në dosje ka kërkuar projekte të ngjashme/furnizime. Paneli Shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh që AK ka kërkuar kioska dhe kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë projekte për punë apo furnizime të ngjashme, AK duhet që ti vërtetoj kontratat e OE-ve se a janë konform kërkesës së tenderit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues dhe shkresave të lëndës, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të tenderëve të vërtetoj se a janë kontratat e ngjashme apo a ka pozicione të njëjta në kontratat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë konform kërkesave të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

[Signature]
z. Goran Milenković

Vendimi t’i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna Vushtrri
- 1x1 OE ankues – N.N.SH “Emsa”- Suharekë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.